



Republika e Kosoves
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 42/16

Prishtinë, më 26.01.2016, ora 11:50

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Adem Grabovci, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri dhe Bardhyl Meta.

Munguan: Ilir Deda, Enver Hoti, Bali Muharremaj dhe Fikrim Damka.

Pjesëmarrës të ftuar: Ymer Havolli-kryesues i Bordit udhëheqës të FKPK-së, Ruzhdi Morina-anetar i bordit të FKPK-së, Vershim Hatipi-Drejtor financiar në FKPK, Ismet Bexheti-kryetar i Bordit të RTK-së, Ivan Veljkovic zëvendës-kryetar i Bordit të RTK-së, Adelina Valla-udhëheqëse e financave në RTK.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Alexandra Fehlinger dhe Rejhane Zylfiq - nga GIZ, Rrahman Ramaj-gazetar nga BIRN, Shefki Kastrati-nga NDI, Fjolla Uka - nga KDI, Sanije Berisha nga OSBE, Lumniqe Murati nga Zyra e Presidentes, Besmir Kokollari-drejtor ekzekutiv nga Ichat, Nore Shabani-gazetare nga Koha Ditore, Pranvera Musliu-gazetare nga Kosova Press, Bardha Shkreli-gazetare nga Radio Kosova

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016;**
- 4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosoves për periudhën Janar-Mars 2016;**
- 5. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015;**
- 6. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - konstatoi se rendin e ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit

Kryetari - konstatoi se procesverbalet e mbledhjeve të mbajtuara më 24.11.2015, 02.12.2015, 03.12.2015, 08.12.2015, 10.12.2015, 14.12.2015 dhe 16.12.2015, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Kërkeses se Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016

Kryetari - Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës në pajtim Ligjin për Fondin Pensional të Kosovës, ka proceduar në Kuvend kërkesën për aprovimin e taksave menaxhuese për vitin 2016. Kërkesa për miratimin e taksave është dërguar në Kuvend vitin e kaluar dhe në mungesë të emërimit të bordit të ri të Fondit, ne nuk kemi mundur të procedojmë me lëndën. Ligji parasheh mundësinë e financimit të Fondit në bazë të taskave të vitit paraprak, deri në miratimin e taksave të reja nga Kuvendi. Fondi ka kërkuar caktimin e taksës operationale prej 0,082% që është 0.003% më e ulët se taksa e vitit 2015 dhe taksës investive që është propozuar 0,398%, që është 0,002 % më e ulët se vitin e kaluar.

Ymer Havolli – theksoi se Fondi vitin e ka përmbyllur me 30 milion euro kthim neto të mjeteve që është rreth 3%. Ky rezultat është arritur duke i marrur parasysh kushtet të cilat kanë mbizotëruar në tregjet financiare si dhe për shkak të diversifikimit të madh që kemi pasur të numrit të aset menaxherëve. Vitin 2016 e fillojmë mbi 1.2 miliard euro mjete nën-menaxhim, kemi 140 milion euro mjete më shumë të mbledhura se vitin kaluar dhe numri i kontribuesve aktiv ka filluar të rritet dhe përafërsisht arrin shifrën 297,500. Fondi këtë vit fillon me implementim të një strategjie në fushën e investimeve, në fushën e përgatitjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore, për shkak se vazhdimisht janë duke u rritur në mjetet të cilat po i menaxhojmë. Mbështetur në këto rrethana, Fondi ka kërkuar nga Kuvendi të miratojë taksën investive prej 0,398%, nga 0,400% sa ishte vitin e kaluar dhe taksën operationale prej 0,082% nga 0,085% se ishte vitin e kaluar. Buxheti të cilën e kemi miratuar është rritur në ato shpenzime ku ka qenë e nevojshme të rritet dhe është zvogëluar kryesisht në ato pjesë të shpenzimeve ku është vlerësuar se mund të bëhen kursime. Prandaj sipas kësaj, taksat e ngarkuara mbi mjetet pensionale zvogëlohen për 1 %, nga 0.485% në 0,480% se ishte në vitin e kaluar dhe në nivelin më të ulët që ka qenë deri më tash.

Kryetari – theksoi se taksat vjetore të propozuar si përqindje janë më të ulëta, por si vlerë absolute e parasë ka rritje në krahasim në vitin e kaluar dhe këtu nuk zvogëlohet sasia e buxhetit. Buxheti i Fondit rritet për 36,6% ndërsa me vlerë të parasë rritet për 52,000 euro. Në krahasim me vitin e kaluar ka rritje tek shpenzimet e personelit ndërsa tek kategoritë tjera ka kryesisht rënie.

Safete Hadergjona – ne po shqyrtojmë çdo herë taksën e Fondit pa e pasur paraprakisht raportin e këtij institucioni, për të parë se si ka shkuar rrjedha e të hyrave dhe shpenzimeve, sa është vlera mjeteve dhe si po menaxhohen mjetet që janë në dispozicion. Sa i përket buxhetit të

miratuar për shpenzime operationale, ne shohim që ka levizje tek kompensimet e Bordit. Ju e dini që institucioni i juaj është më i diskutuar për pagat e larta dhe e kam parasysh se jeni një institucion pak më specifik, mirëpo edhe pse keni dhënë një sqarim se nuk ka pasur ndryshime një kohë të gjatë, si dhe për shkak të influencionit, nuk mendoj që duhet të bëjmë lëvizje në pagat apo kompensimet e anëtarëve të bordit në drejtim pozitiv. Një qështje tjetër që kam nevojë për sqarim që e kam hasur tek kontrata kolektive, ku thotë që shpenzimet për stazhin e të punësuarve në vitin 2015 u mbuluan nga rastësitë. A keni mundësi të na sqaroni, çka konsideroni ju si rastësi?

Ymer Havolli - sqaroj se raporti vjetor i Fondit dërgohet në Kuvend pasi që të auditohet. Unë pajtohem me kërkesat që raporti duhet të jetë sa më i detajuar dhe të ketë të dhëna sa më shumë që të jetë mundur. Diversifikimi i investimit të mjeteve në tregjet financiare na ka mbajtur në një pozitë që ne kemi qenë të suksesshëm dhe sigurisht që diversifikimi dhe numri i aset menaxhereve ka një kosto. Kuvendi në vitin 2002 ka vendosur kompenzimin e anëtarëve të bordit dhe është i njohur për të gjithë. Secili anëtar i bordit, vendor apo ndërkombëtar kompensohet me një shumë prej 1250 euro. Rritja e buxhetit për personelin, është bërë edhe për shkak se është shtuar një anëtar vendor dhe çështja e funksionimit të komiteteve të bordit, që është një rekomandim i Bankës Qëndrore për anagazhimin e anëtarëve të jashtëm.

Besa Gaxherri – edhe pse u përmendën të gjitha, vetëm po e ritheksoj edhe një herë që fitimin e keni realizuar 3%, ndërsa ulja e taksës është për 1 %. Nëse keni rritje 3% dhe si shumë totale mjetet nën-menaxhim janë mbi 1,2 miliard euro, atëherë në bazë të rritjes së mjeteve ne duhet të ulim taksat. Pa dashur që të hyjmë në detaje por kur e shohim ngritjen e shpenzimeve operationale për 36%, për kompenzimin e stafit duhet pasur kujdes pasi që paraqet një pasqyrë jo të mirë tek opinioni.

Kryetari – një qështje tjetër që më intereson është se në cilën bazë të mjeteve caktohen taksat, a duhet të caktohet taksa në mjetet e grumbulluara apo duhet të caktohet në bazën e mjeteve të planifikuara? Ju tani i keni kalkuluar taksat bazuar në mjetet e planifikuara dhe mbi bazën e kësaj i keni propozuar taksat menaxhuese. Unë konsideroj që ne duhet që këtë qështje ta diskutojmë bashkarisht me Bordin dhe të kemi një përfundim se ku është baza që nxirret taksa menaxhuese. Si përfundim propozoj që si komision ta përkrahim kërkesën dhe ti rekomandojmë Kuvendit që të aprovohet taksën operationale prej 0,082% dhe taksën investive prej 0,398%, që dmth se Buxheti i Fondit për vitin 2016 do të jetë 6,528,379 euro dhe në këtë shumë duhet të llogariten edhe shpenzimet të cilat janë bërë nga Fondi deri në miratimin e taksave të reja vjetore nga Kuvendi për vitin 2016.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë

Rekomandim

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operationale prej 0,082% dhe taksës investive prej 0,398%, për vitin 2016.

4. Shqyrtimi i Programit të Shpenzimeve të Radiotelevizionit të Kosovës për periudhën Janar-Mars 2016

Kryetari - theksoi se me Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016, Radio Televizioni i Kosovës është shtuar si Organizatë Buxhetore si dhe shuma prej 4,800,000 euro që figuron në kategorin ekonomike subvencione dhe transfere. Në nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit për Buxhetin 2016 është përcaktuar që para secilit tre mujor, RTK do të dorëzoj në Kuvendin e Kosovës programin e shpenzimeve të planifikuara, si dhe në fund të çdo tremujori raportin për shpenzimet e bëra. Mbi këtë bazë ligjore RTK ka dorëzuar planin e shpenzimeve për tre mujorin e parë dhe ka kërkuar që të lejohet transferi i mjeteve të këstit të parë në shumë prej 2,400,000 euro.

Ismet Behxheti - nuk kemi diqka të shtojmë, pos që mund të themi se programin e të hyrave dhe shpenzimeve për gjashtëmujorin dhe tremujorin, fillimisht e kemi pasur të parapërgatitur bazuar në vitin paraprak dhe ashtu siç është kërkuar me ligjin për buxhetin, ne kemi dërguar në Kuvend.

Bardhyl Meta - vitin e kaluar kur e kemi aprovuar Buxhetin jemi marrur vesh që të formohet edhe grupi punues që të inicohet nga Parlamenti, që të rregullojë çështjet e pazgjidhura të RTK-së. Aty janë disa qështje të kontestueshme në mes të tyre edhe prona, vendi ku mund të ndërtohet, forma e financimit. Kuvendi është i obliguar që të bëjë një zgjidhje. Prandaj unë mendoj që ju kryetar i Komisionit të kërkon prej Kryeministrit dhe prej të gjitha trupave të Kuvendit që ka nevojë ta formojmë një grup serioz pune, në përbërje të komisionit funksional, komisionit tonë dhe përfaqësuesve të qeverisë, që të punohet për ndryshimin e ligjit dhe të zgjidhen problemet brenda këtij gjashtëmujori. Prandaj është me rëndësi që koalicioni i madh që ti merr punët e mëdha dhe t'i kryej ato me ligj.

Safete Hadergjonaj – unë kisha pasur një rekomandim për juve si RTK, nisur edhe nga përvoja e mandatit të kaluar me të cilën jemi përballur me problemet e alokimit të mjeteve për insitucionin e juaj, që të na dërgoni me kohë kërkesën për alokimin e mjeteve për tremujorin e dytë. Po ashtu kam një kërkesë për kryetarin që në takimet që mbahen në mes Kryetarit të Kuvendit dhe kryetarëve të komisioneve, të ngritet qështja e ndryshimit dhe plotësimit të ligjit të RTK-së, që në njëfarë mënyre është e ndërlidhur me punën e dy komisioneve. Meqenë se ndryshimi i ligjit është përgjegjësi e komisionit funksional është mirë që në grupin punues të jetë edhe dikush nga komisioni për buxhet dhe financa sepse vërtetë kur vie qështja tek financat, komisionet tjera jo gjithëherë na sjellin rekomandime që janë në favor të zgjidhjes së problemit dhe po na ngatërrojnë punën edhe më shumë. Pajtohem plotësisht me z. Meta që koalicionet e mëdha duhet t'i zgjedhin problemet e mëdha dhe shpresoj që kemi edhe ekspertizën në kuadër të këtij koalicioni edhe njerëzit edhe mundësitë që i zgjedh problemet me të cilat po përballemi.

Kryetari – propozojë që Komisionit të nxjerr rekomandim për Ministrinë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, që të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së, për periudhën 1 Janar - 31 Mars 2016, në shumën prej 2,4 milion euro. Po ashtu RTK në pajtim me Ligjin e Buxhetit për vitin 2016, para fillimit të tremujorit të dytë, duhet të dorëzojë në Kuvend programin e shpenzimeve për periudhën Prill-Qershor 2016, si dhe Raportin e shpenzimeve të

bëra për tremujorin e parë të këtij viti. Komisioni më pas do ta shqyrtojë këtë Raport dhe programin e shpenzimeve për tremujorin e dytë dhe do të nxjerr rekomandime për Ministrinë e Financave.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, kryetari konstatoi se komisioni njëzëri nxorri këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomadohet Ministrisë së Financave, respektivisht Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr.1110101219060187, për periudhën 1 Janar - 31 Mars 2016, në shumën prej 2,400,000 (dy milion e katërqind mijë) Euro.
2. Radiotelevizioni i Kosovës në pajtim me nenin 9, paragrafi 6 të Ligjit nr. 05/L-071 të Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2016, para fillimit të tremujorit të dytë, duhet të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës, Programin e shpenzimeve për periudhën Prill-Qershor 2016, si dhe Raportin e shpenzimeve të bëra për tremujorin e parë të viti 2016.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, do ta shqyrtojë Raportin e shpenzimeve tremujore dhe Programin e shpenzimeve të RTK-së për periudhën Prill-Qershor 2016 dhe do të nxjerr rekomandime për Ministrinë e Financave, për transferin e mjeteve buxhetore në llogarinë e RTK-së për tremujorin e dytë të vitit 2016.

5. Miratimi i Raportit vjetor të punës së Komisionit për vitin 2015

Sipas propozimit të kryetarit, pika e pestë e rendit të ditës u shty për mbledhjen e radhës së komisionit.

Mbledhja përfundoi në ora 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani